


●● SËMUNDJET E KUJTESËS ME ORIGINË NGA ENËT E GJAKUT

Sëmundje të ndryshme të kujtesës që janë si pasojë e çrregullimeve të qarkullimit të gjakut në tru dhe të dëmtimeve të enëve të gjakut në tru, quhen sëmundje kujtese me origjinë nga enët e gjakut (vaskulare). Faktorët e rrezikut të sëmurjes ndërlidhen me ambientin dhe zakonet e jetesës sikur p.sh. vlerat e larta të kolesterolit dhe të tensionit të gjakut, diabeti, alkooli dhe pirja e duhanit.



Shkaktarë të sëmurjes pos tjerash janë infarktët e trurit, gjakderdhjet në tru, mungesa e oksigjenit në tru si dhe çrregullimet në qarkullimin e gjakut në tru. Zhvillimi i mëtejshëm i sëmundjes është individual dhe varet nga ajo se në cilën pjesë shtrihet dëmtimi. Çrregullimet në qarkullimin e gjakut në tru janë shkaktari i dytë më i përhapur i sëmundjeve të kujtesës pas sëmundjes së Alzheimerit. Në këso raste zakonisht shkakun qëndron te sëmundja e kapilarëve të gjakut në tru.



Sëmundjet e kujtesës me origjinë nga enët e gjakut ndahen në shumë lloje duke u bazuar në atë se ndryshimet në tru a janë më shumë në lëvore apo në pjesët e thella të trurit, në të ashtuquajturën materie e bardhë.

Simptoma të sëmundjes mes tjerash janë



Dëmtimi në gjysmën e majtë të trurit shkakton çrregullime gjuhësore, ndërsa në të djathtën shkakton vështirësi në konfigurim. Dëmtimet në pjesët e thella të trurit shpesh shkaktojnë ngadalësim të aftësisë vepruese.



Drejtimi i veprimit vështirësohet, pra i sëmuri shpesh e ka të vështirë ta planifikojë veprimtarinë, të fokusohet në një çështje, të konfigurujë tërësitë dhe të shkojë më tutje në mënyrë sistematike.




Pasiviteti, dobësimi i aftësisë së nismës dhe vështirësimi i konfigurimit të hapësirës janë simptoma të tilla si dhe pasqerishtë janë tipike problemet me kërkimet nga kujtesa.



Nga sëmundja mund të pasojë ankth dhe depresion. Gjithashtu ndjeshmëria emocionale dhe ndryshimet e disponimit janë simptoma tipike. Te sëmundjet e kujtesës me origjinë nga enët e gjakut, kujtesa ruhet më mirë sesa te sëmundja e Alzheimerit. Aftësia vepruese ndryshon dhe gjithashtu edhe përmirësim të gjendjes mund të ndodhë.

BUSOLLA E TRAJTIMIT TË MIRË TË SËMUNDJEVE TË KUJTESËS

Adetet e shëndetshme të jetesës dhe në rast nevojë edhe ndryshimi i adeteve të jetesës janë pjesë e trajtimit të mirë të sëmundjes. Po aq me rëndësi është që të mbështetet në mënyra të ndryshme vazhdimi i jetës kuptimplote.



Gjatë trajtimit të sëmundjeve të kujtesës me origjinë nga enët e gjakut përqendrohemi në shkaktarët dhe faktorët rrezikues të saj si dhe trajtojmë edhe sëmundjet tjera eventuale. Trajtimi i mirë i sëmundjes së kujtesës përmban fushat në vijim: fizikultura, gjumi i mjaftueshëm, ushqimi i shëndetshëm, mirëqenia e zemrës, relacionet sociale, aktivizimi i trurit dhe aktivitetet e lira, jeta pa substanca dehëse dhe narkotike dhe trajtimi me barna sipas nevojës.

Lähteet:

www.muistiliitto.fi

www.terveyskirjasto.fi

www.kaypahoito.fi

Kuva ja taide: Karen Cipre

karencipre.deviantart.com



**Salon
Muistiyhdistys ry**
Muistiliiton jäsen

